

Takim rajonal në Kumanovë

Pasi u mbajtën takimet rajonale në Tetovë, Kërçovë, Strumicë, Manastir dhe Shtip, më 21 janar 2009 u mbajt takim rajonal i Zëvendës Avokatit të Popullit – zyra rajonale në Kumanovë me Komisionet për marrëdhënie me komunitetet dhe këshillat e Komunave të Kumanovës, Likovës, Staro Nagoriçanes, Rankovces, Kratovës dhe Kriva Pallankës.

Qëllimi i takimit, në të cilin morën pjesë 38 pjesëmarrës, ishte të iniciohet bashkëpunimi mes Avokatit të Popullit, komisioneve për marrëdhënie mes komuniteteve dhe këshillave komunal nga rajoni për çështje të cilat kanë të bëjnë me bashkësitë etnike jo shumicë.

Në takim fjalim mbajti Naser Veseli, Zëvendës Avokat i Popullit nga zyra rajonale në Kumanovë, Dolores Rexhepovska – referente për çështjet e romëve në komunën e Kriva Pallankës dhe përfaqësues të Komisioneve për marrëdhënie mes komuniteteve nga Kumanova, Kratova dhe Staro Nagoriçane.

Zëvendës Avokati i Popullit Naser Veseli i paraqiti kompetencat e institucionit Avokat i Popullit për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve etnike jo shumicë dhe zbatimin e përfaqësimit adekuat dhe të drejtë në rajon, duke theksuar se komunitetet e vogla etnike nuk janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate nëpër institucione. Ai bëri thirrje për një bashkëpunim më të madh mes Avokatit të Popullit, këshillave komunal dhe komisioneve për marrëdhënie mes komuniteteve me qëllim të realizimit të drejtave të qytetarëve. Përfaqësuesit e Komisioneve për marrëdhënie mes komuniteteve nga Kumanova, Likova, Kriva Pallanka dhe Staro Nagoriçani folën për strukturën dhe funksionimin e komisioneve. Konkludimi gjeneral ishte se këto komisione ekzistojnë vetëm formalisht dhe nuk mbajnë takime edhe pse funksionimi i tyre dhe ekzistimi i referentëve për çështje etnike është shumë e rëndësishme për bashkësitë etnike që nuk janë shumicë. Në takim u theksua se qytetarët nuk i dinë kompetencat e Avokatit të Popullit dhe nevojitet që institucionet të afrohen te qytetarët. Roli i komisioneve për marrëdhënie mes komuniteteve duhet të forcohet dhe të përmirësohet funksionimi i tyre, kurse bashkëpunimi rajonal mes komunave i incizuar në këtë takim duhet të vazhdojë në të ardhmen.

Takimi rajonal është pjesë e projektit **Jetesa në mjedis multietnik – qytetarë me të drejta, mundësi dhe mbrojtje të barabartë**, i financuar nga Komisioni Evropian dhe FISHHM në bashkëpunim me Vlera të Përbashkëta – Shkup dhe Qendrën Rajonale për Zhvillim të Qëndrueshëm Kratovë (ish Qendra për Përkrahjen e OJQ-ve).